



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:081845

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05747649

**P.nr.147/2024**

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunëtoren profesionale Albinë Velekinca Sadiku, në çështjen penale kundër të pandehurit S... K... nga Gj., për shkak të veprës penale dhunë në familje nga neni 248 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 nën paragraf 3.1 dhe 3.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës), duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me numra PP.II.nr.325/2024, të datës 12.03.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 22.05.2024, mori dhe shpalli, ndërsa me datë 24.05.2024 përpiloi këtë:

### AKTGJYKIM

I pandehuri S... K..., nga babai A... dhe nëna K..., e gjinisë L..., i lindur më datë ..., në fsh.L..., Komuna e Kamenicës, me vendbanim në Gjilan në rr. "...", nr. objekti ...,nr..., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, puntorë, i gjendjes së varfër ekonomike, me numër personal .... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 02.03.2024 rreth orës 19.00h, në Gjilan, në shtëpinë familjare, i pandehuri, me dashje dhe me qëllim të ushtrimit të pushtetit dhe kontrollit, cenimit të dinjitetit të dëmtuarës vajzës së tij të mitur Sonila Kërçeli, ka ushtruar dhunë në familje në kundërshtim me nenin 3 nën par.1.3 të Ligjit 08/L-185, në atë mënyrë që fillimisht i kërkon të lë telefonin, dhe pasi e dëmtuara nuk e përfill, i pandehuri i bërtet dhe i revoltuar ngritët dhe ia merr kabllin e telefonit

nga dora duke ia këputur, ku edhe pason një mosmarrëveshje verbale me bërtitma të dyanshme ku i pandehuri e përul duke e quajt me terma fyes dhe i revoltuar e kap për krahu me forcë dhe merr një holluese duke tentuar ta godas mirëpo ndërhyr nëna e vajzës dhe e parandalon, që si pasojë të dëmtuarës pos që i cenon dinjitetin me sjelljen dhe veprimet e tija i shkakton dhembje dhe shqetësim të madh emocional .

**-Me çka ka kryer veprën penale dhunë në familje nga neni 248 par.3 nën par.3.1 dhe 3.2 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,38,46,47,48,49,50,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 242 e 364 të KPP-ës, të pandehurës së lartcekur i shqipton:

## DËNIM ME KUSHT

Të pandehurin **S....K....** , i shqiptohet dënim me gjobë në kohëzgjatje prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë) euro, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej **120** (njëqind e njëzet) ditëve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet në kuptim të nenit 50 dhe 51 të KPRK-s.

Nëse të pandehurit e lartcekur, nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguajë dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që 1 (një) ditë burgim do t'i llogaritet për çdo 20 euro, të dënimit me gjobë.

Obligohet i pandehuri e lartcekur që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 € (njëzetë -euro), si dhe shumë prej 20 € (njëzet-euro), për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## ARSYETIM

### Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 12.03.2024, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.325/2024, kundër të pandehurit: nga Gjilan, për shkak të veprës penale dhunë në familje nga neni 248 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 nën parag 3.1 dhe 3.2 të KPRK-ës.

Në shqyrtimin fillestar të datës 22.05.2024, ishin prezent Prokurori i Shtetit, i pandehuri, si dhe e dëmtuara Sonila Kërqeli, në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, deklarohet se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen kësaj vepre penale, ndërsa i premtun gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris këtë vepër apo vepër tjetër penale duke kërkuar që ti shqiptohet një dënim më i butë, andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit dhe rrjedhimisht shqyrtimi fillestar ka vazhduar me deklaratimet e palëve lidhur me dënimin.

### Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurores të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit Sahit Kërqeli, për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike gjithnjë.

### Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj vepre, ekziston fakti se i pandehuri ..... nga Gjilani, për shkak të veprës penale dhunë në familje nga neni 248 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 nën parag 3.1 dhe 3.2 të KPRK-së, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve dhe të mbrojtësit lidhur me dënimin, e ka shpallur fajtor të akuzuarin, për shkak të veprës penale dhunë në familje nga neni 248 të KPRK-ës, parasheh se kushdo që e kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare, e posaçërisht në paragrafi 1 të këtij neni parashihet se çdo kushdo që e kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare.

### **Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht, ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën, janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë një dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit e të pandehurit, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 69 dhe 72 të KPRK-së, Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin dhe ndaj të pandehurit ka shqiptuar këtë dënim, se i pandehuri ka bashkëpunuar me prokuroren e shtetit, pranimin e fajësisë e ka bërë në shqyrtim fillestar, se i pandehuri është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, e se i njëjti ka premtuar se nuk do të kryej vepra tjera penale, dhe fakti që nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër penale të kësaj natyre. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i pandehuri me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale. Ndërsa, rrethanë rënduese ka marrë shkallen e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërisë shoqërore.

### **Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar**

Gjykata, ka konstatuar se me dënimin e kushtëzuar, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### **Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike**

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 462 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, e ka udhëzuar të dëmtuarën Sonila Kërçeli, por e njëjta në seance ka deklaruar se nuk do ti bashkëngjiten ndjekjes penale dhe nuk do të parashtrij kërkesë pasurore juridike.

### **Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale**

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit gjykata duke u bazuar në nenin 449 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të pandehurin ta obligojë ti paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet- euro), si dhe shumën prej 20€ (njëzet-euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto, pas ditës pasuese të plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**P.nr.147/24, me datë 22.05.2024**

**Gjyqtari**

**Veli Kryeziu**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej **30 ditëve** nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjiilan.